



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, ASETIVE
DHE SHËRBIMEVE

Nr. 3375/11 Prot.

Tiranë, më 23.6. 2021

Lënda: Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓
Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga “Naim Frashëri” Nr. 37, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Blv: “Zhan D’Ark”, Nr.23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR
Rruga e Durrësit, Tiranë

Në zbatim të pikës 25 të nenit 2 dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, dhe udhëzimit nr. 12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të merren masat për zbatimin e detyrave të mëposhtme:

1. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) pranojnë dosjet e kandidatëve të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e mësuesit dhe të marrin pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021 deri në datën 30.06.2021.
2. Kandidati që dëshiron të ushtroj profesionin e mësuesit dhe të marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021, duhet të regjistrohet online në portalin *mesuespershqiperine.al* deri në datën 30.06.2021. Kandidati ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet për konkurrim. Një kopje të dokumentacionit të ngarkuar online, për efekt të vlerësimit të dosjes e dërgon nëpërmjet shërbimit postar në DRAP-in ku ka qendrën e banimit, sipas ndarjes territoriale në aneksin nr. 1 të kësaj shkrese.
3. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të këtij Udhëzimi, kandidati e dorëzon

edhe në DRAP-në ku ka qendrën e banimit brenda datës 30.06.2021. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:

- a) Aplikoj për herë të parë, b) Mbart pikët aktuale (dosje+testim), c) Mbart vetëm pikët e dosjes, d) Mbart vetëm pikët e testimit. Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që janë regjistruar online në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe që kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.
4. DRAP-et krijojnë Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve i cili administron dhe vlerëson dosjet e kandidatëve sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, brenda datës 08.07.2021.
5. DRAP-et në përfundim të procedurës së vlerësimit të dosjeve njoftojnë kandidatët për vlerësimin që kanë marrë brenda datës 09.07.2021.
6. DRAP-et dërgojnë elektronikisht dhe zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, listat e kandidatëve të kualifikuar, duke përcaktuar për çdo kandidat ZVAP-të ku dëshirojnë të konkurrojnë dhe pikët e dosjes brenda datës 10.07.2021.
7. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë për vlerësimin e marrë brenda datës 10.07.2021.
8. DRAP përgatit dhe dërgon në DPAP listën e kandidatëve që kanë kërkuar të ruajnë pikët e testimit dhe pikët e dosjes së portalit 2020 brenda datës 16.07.2021.
9. Shqyrtimi i ankesave, hartimi dhe shpallja e listës finale të bëhet brenda datës 21.07.2021.
10. DPAP dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, elektronikisht dhe zyrtarisht listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar.
11. Qendra e Shërbimeve Arsimore organizon testimin e informatizuar, sipas kalendarit të miratuar dhe të publikuar prej saj, në zbatim të Udhëzimit nr. 12, të MASR-së, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
12. Qendra e Shërbimeve Arsimore dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP, listat e kandidatëve me pikët e fituara në testimin e informatizuar 2021.
13. DPAP dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në MASR dhe në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), listat e kandidatëve me pikët e dosjes dhe pikët e testimit të informatizuar 2021, si dhe pasqyron në portalin “Mësues për Shqipërinë” pikët për secilin kandidat.
14. DPAP informon DRAP-et dhe ZVAP-të, lidhur me këtë shkresë dhe procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI